




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-
SIGURIMIT TË SHETIT**



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHETIT

Nr. 1228 Prot.

Tiranë, më 27.06.2025

**UNIVERSITETI I SHKODRËS
“LUIGJ GURAKUQI”**



Nr. 2256 Prot.

Shkodër, më 26.06.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

PËR

**KOORDINIMIN E PUNËS SË NDËRSJELLË DHE INSTITUCIONALIZIMIN E
MARRËDHËNIEVE**

E lidhur sot, më datë 26.06.2025, në Shkodër, ndërmjet palëve:

1. Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, (referuar më tej si “Autoriteti”/“AIDSSH”), me seli në Tiranë, me adresë në Njësinë Administrative nr. 4, rruga “E Dibrës”, garnizoni “Skënderbej”, përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, kryetari i Autoritetit,

dhe

2. Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, (referuar më tej si “Universiteti”/“USH”), me seli në Shkodër, me adresë në sheshin “2 Prilli”, përfaqësuar nga Prof.dr. Tonin Gjuraj, rektori i Universitetit; *i cili vendos në fokus të bashkëpunimit në këtë marrëveshje, për shkak të ekspertizës dhe kualifikimit në përmbushje të objektit dhe qëllimit të saj, njësitë kryesore si vijon:*

- Fakultetin e Shkencave Shoqërore;
- Fakultetin e Drejtësisë;
- Fakultetin e Shkencave të Edukimit;

Palët janë dakortësuar se, për të konkretizuar bashkëpunimin ndërmjet tyre, do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje të nënshkruar midis Autoritetit dhe Universitetit, është konkretizimi i formave zyrtare të bashkëpunimit ndërinstitucional, me vëmendje parësore në fushën e kujtesës kolektive, rishqyrtimit të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit dhe të ngjarjeve historike të lidhura me periudhën e regjimit totalitar komunist. E gjitha kjo do të shërbejë për të informuar publikun, për të hedhur dritë mbi të shkuarën dhe për të ndërgjegjësuar brezat e rinj, në kuadër të punës dhe të veprimtarisë për zbulimin e të vërtetave historike dhe në nxitjen e kërkimit shkencor, edukimit qytetar dhe promovimit mediatic për të kaluarën komuniste në Shqipëri.

2. Kjo marrëveshje synon të formalizojë bashkëpunimin ndërmjet palëve në fushën e studimeve, kërkimeve shkencore dhe botimeve të përbashkëta mbi periudha dhe ngjarje të periudhës së diktaturës me rëndësi për historinë, promovimin e dialogut lokal dhe për aktivitetet që përfshihen në të, mbi çështje të kujtesës, përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në projektet kërkimore nisur nga burimet e gjendura në arkivin e AIDSSH-së, me qëllim njohjen e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, dëshmime gojore dhe burimeve bibliografike për historinë lokale, por jo vetëm, duke i dhënë rëndësi studimore edhe ndikimeve sociale dhe kulturore, si edhe efekteve të ardhura në jetët e njerëzve.

3. Mbështetur në bazë të premisave të përligjura prej neneve 36 dhe 38 të ligjit nr. 45/2015, *“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, të ndryshuar, bashkëpunimi synon të forcojë rolin e Universitetit dhe Autoritetit në edukimin dhe studimin e historisë kombëtare, duke angazhuar studentët dhe komunitetin akademik në iniciativa me ndikim të gjerë shkencor dhe shoqëror.

Neni 2

Baza ligjore

Kjo Marrëveshje bazohet në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*; Ligjin nr. 45/2015, *“Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, e ndryshuar; Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, *“Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”*; Ligjin nr. 80/2015, *“Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”*; Ligjin nr. 35/2016 *“Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të”*, e ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 27.02.2019, *“Për Përcaktimin e Tarifave dhe të Pagesave për Shërbimet ndaj Institucioneve apo Personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*; Statutit të Universitetit të Shkodrës *“Luigj Gurakuqi”*; Rregullores *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*,

miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit; dhe në Planin Strategjik 2023-2028 të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Neni 3

Objekti

Kjo marrëveshje bashkëpunimi, ka si objekt:

- a) Institucionalizimin e marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet palëve, në funksion të rishqyrtimit të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit në veçanti dhe rishikimit të historisë së regjimit totalitar komunist në përgjithësi;
- b) Realizimin e kërkimeve shkencore në fushën e studimeve historike me kontekst vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- c) Fuqizimin e edukimit dhe të ndërgjegjësimit për të kaluarën;
- d) Promovimin e dialogut vendor dhe të pjesëmarrjes qytetare duke nxjerrë në pah proceset politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe artistike që kanë ndodhur në qytetin e Shkodrës, por edhe në të gjithë Shqipërinë, gjatë periudhës së komunizmit, sipas konceptit që Autoriteti ka për promovimin dhe nxitjen e dialogut lokal dhe manualit për pushtetin vendor, por pa u kufizuar vetëm në to.
- e) Zhvillimin e projekteve dhe të platformave të përbashkëta;
- f) Shfrytëzimin reciprok të dokumentacionit arkivor të Autoritetit dhe të materialeve që zotërohen prej Universitetit, në kuadër të veprimtarive shkencore apo aktiviteteve përkujtimore të përbashkëta apo të njëanshme që palët mund të ndërmarrin;
- g) Organizimin e veprimtarive të përbashkëta, në kuadër të edukimit qytetar, ku të evidentohen roli i ish-Sigurimit të Shtetit në shoqërinë shqiptare të viteve 1944-1991, shtypja dhe mohimi i të drejtave të njeriut përgjatë diktaturës komuniste, si dhe format e ndryshme të kundërshtimit të regjimit totalitar.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e palëve

1. Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, Autoriteti dhe Universiteti, kanë të drejta dhe detyrime, si dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të qëllimeve për të cilat ushtrojnë veprimtarinë.
2. Konkretisht, palët marrin përsipër:
 - a) Shkëmbimin e planeve vjetore të miratuara, përsa u takon projekteve dhe veprimtarisë në fusha të përbashkëta, çdo fillim viti;
 - b) Bazuar në planet vjetore, nxitjen dhe nismëmarrjen e bashkëpunimit në projekte të përbashkëta hulumtuese, të karakterit studimor, informues dhe edukues qytetar mbështetur nga homologë e partnerë vendas apo të huaj;
 - c) Organizimin e konferencave të përbashkëta me qëllim inkurajimin e studimeve mbi historinë e diktaturës komuniste, ish-Sigurimit të Shtetit dhe represionit politik dhe ndikimin e ardhur në shoqërinë shqiptare;

- d) Botimin dhe promovimin e rezultateve të studimeve akademike në konferenca nëpër qarqe, faqe, medime dhe revista shkencore;
- e) Krijimin dhe organizimin e projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta mbi kujtesën historike, kthimin në vende kujtese të vuajtjeve të viktimave të vendeve historike, si dhe përkujtimin e datave të kujtesës;
- f) Hartimin dhe promovimin e paketave trajnuese për studentët, nxënësit, pedagogët dhe mësuesit mbi mësimin e historisë dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, duke marrë shkas nga burimet e gjendura nën administrim nga palët;
- g) Leksione të hapura, seminare dhe tryeza të hapura me ekspertë dhe studiues;
- h) Zhvillimin e materialeve didaktike për përdorim në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë;
- i) Zhvillimin dhe kryerjen e praktikave studentore dhe të projekte studimore pranë AIDSSH-së;
- j) Mbështetjen e punimeve të diplomës dhe të kërkimeve akademike të stafit pedagogjik dhe studentëve të Universitetit, për tematika që lidhen me kujtesën historike, të drejtat e njeriut, etj., për të cilat ekzistojnë burime mbështetëse në AIDSSH, duke mbështetur dhe lehtësuar punën në arkivën e Autoritetit, nëpërmjet ndihmës teknike;
- k) Organizimin e veprimtarive dhe ngjarjeve që sjellin së bashku studiues, ish-të përndjekur politikë, studentë dhe komunitetin në shkallë të gjerë publike për të diskutuar mbi të kaluarën dhe mësimet e saj për të ardhmen. Të tilla veprimtari, nisma, ngjarje, etj., përfshijnë ato që palët kryejnë më vetë me nismën e tyre, por edhe të përbashkëta (si klube libri, klube filmi, ekspozita, leksione, etj.);
- l) Përdorimin e teknologjisë dhe të mjeteve digjitale për të shpërndarë materiale edukative dhe studimore që rrjedhin nga ky bashkëpunim;
- m) Forcimin e bashkëpunimit me institucione të tjera akademike dhe organizata ndërkombëtare për të zgjeruar mundësitë e dialogut dhe kërkimit shkencor me qëllim njohjen sa më mirë të historisë, kur është mundur;
- n) Palët shkëmbejnë materiale shkencore dhe informative të prodhuara, në formë digjitale, me qëllim promovimin e vlerave historike dhe të të drejtave të njeriut, në përputhje me interesat e palëve duke respektuar legjislacionin në fuqi;
- o) Palët bashkëpunojnë me materiale të të gjitha formave në kuadër të platformës “Mësojmë mbi të shkuarën, 1944-1991 – Burime arsimore të hapura”;
- p) Palët bashkëpunojnë me materiale të të gjitha formave në kuadër të platformës së Mediatekës
- q) Palët mundësojnë dhënien e dublikatave të materialeve të tyre arkivore të çfarëdolloj forme, kur diçka e tillë kërkohet nga pala tjetër, gjithmonë në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet tyre, brenda kuadrit ligjor përkatës të secilës;
- r) Palët shkëmbejnë botimet dhe publikimet e tyre, me synim pasurimin e bibliotekave përkatëse;
- s) Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 13.02.2019, *“Për Ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të Shërbimeve, në Përputhje me Veprimtarinë e tyre, për Institucionet e Qeverisjes Qendrore dhe Institucionet në Varësi të tyre”*, ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.186, datë 27.03.2024, *“Për disa Ndryshime në Vendimin nr. 188, datë 13.03.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për Ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të*

Shërbimeve, në Përputhje me Veprimtarinë e tyre, për Institucionet e Qeverisjes Qendrore dhe Institucionet në Varësi të tyre'', palët marrin përsipër lidhjen e kontratave të shërbimit për ofrimin prej Universitetit në mbështetje të AIDSSH-së të shërbimeve për zhvillimin e narrativave për mediatekën dhe redaktimin shkencor të botimeve, duke siguruar një qasje profesionale dhe të thelluar në materialet e publikuara;

- t) Autoriteti ofron mundësinë që stafi pedagogjik dhe studentët e Universitetit të kenë të drejtë të hulumtojë dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit, të ruajtura në arkivën e Autoritetit, si dhe të përfitojnë kopje/dublikata kundrejt një tarife të reduktuar, në përputhje me parashikimet ligjore trajtuese;
- u) Autoriteti mundëson vënien në dispozicion të mjediseve të veta, për aq sa është e mundur në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar, në rast se diçka e tillë kërkohet në kuadër të këtij bashkëpunimi lidhur me veprimtaritë e përbashkëta;
- v) AIDSSH-ja do të angazhojë studentët e Universitetit në punë dhe veprimtari praktike, të tilla si, por pa u kufizuar vetëm në, transkriptimin e dëshmime historike, për të kontribuar në përpunimin dhe dokumentimin e burimeve të ish-Sigurimit për qëllime akademike;
- w) Universiteti do të përfshijë studentët e programeve "Master" në krijimin e tezave të tyre shkencore, duke i orientuar kërkimet e ciklit të tretë drejt analizës dhe përdorimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit për studime historike dhe kulturore;
- x) Universiteti vë në dispozicion mjediset e veta në kuadër të veprimtarive të përbashkëta, kur diçka e tillë është e nevojshme;
- y) Universiteti mundëson asistencë teknike profesionale nëpërmjet stafit të tij pedagogjik, për çështje me karakter studimor dhe akademik, në kuadër të nismave që vijnë si pasojë e këtij bashkëpunimi, apo edhe kur bëhet fjalë për një nismë të mëvetme të Autoritetit;
- z) USH do të koordinojë përfshirjen e studentëve dhe pedagogëve në projektet dhe studimet dhe pjesëmarrje në aktivitet të përbashkëta.

3. Në përmbushje të objektit dhe qëllimit të kësaj marrëveshjeje, palët miratojnë jo më vonë se tremujori i parë i çdo viti kalendarik, planin e punës, i cili do të përmbajë veprimtaritë, afatet dhe detyrat e përgjegjësitë e palëve, i cili do të miratohet jo më vonë se data 31.07.2025 në vitin e parë të hyrjes në fuqi të marrëveshjes. Gjithmonë, plani i përbashkët do të kryhet pasi të jenë shkëmbyer planet përkatëse të mëvetme ndërmjet palëve.

4. Për çdo veprimtari të përbashkët, palët angazhohen që të garantojnë kontribut nga të dyja institucionet me burime njerëzore dhe nga ana logjistike për realizimin e tyre.

5. Palët angazhohen për promovimin aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta në platformat dhe mediumet e tyre zyrtare (faqe interneti, rrjete sociale, publikime).

6. USH, sipas kontratave të shërbimit që mund të nënshkruajë me AIDSSH- në, në përputhje Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 13.02.2019, "*Për Ofrimin nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të Shërbimeve, në Përputhje me Veprimtarinë e*

tyre, për Institucionet e Qeverisjes Qendrore dhe Institucionet në Varësi të tyre”, e ndryshuar, garanton dhënien e ekspertizës dhe të ndihmës teknike, në procesin e përpunimit dhe përpilimit të publikimeve të Autoritetit në përputhje me standartet shkencore.

Neni 5

Të drejtat e shfrytëzimit dhe pronësia intelektuale

1. Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të veprave të cilat zotërohen nga USH janë në përputhje me legjislacionin shqiptar të kohës (në vijim “Veprat”) duke zbatuar parashikimet e legjislacionit për të drejtën e autorit.
2. Të gjitha të drejtat ekskluzive të shfrytëzimit pasuror të dokumenteve dhe të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të organeve të diktaturës komuniste të periudhës kohore 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991 (në vijim “Materialet Dokumentare”), të cilat zotërohen nga Autoriteti, në përputhje me legjislacionin shqiptar, janë në pronësi të vetme të Autoritetit.
3. Të gjitha krijimet dhe pronat intelektuale (intervista, dokumentacion arkivor, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e palës, e cila i ka në pronësi.
4. Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe të planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për periudhën e kohës gjatë së cilës zgjat marrëveshja. Gjithmonë, palët do të ruajnë përkatësinë pronësore dhe shpërndarëse të materialeve, duke përmendur kontributin e vënies në dispozicion.
5. Të gjitha pronat intelektuale, të cilat krijohen si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi dhe në kuadrin e veprimtarive që rrjedhin prej tij, me kontributin e të dyja palëve, do të jenë në pronësi të të dy institucioneve dhe do të shfaqen e do të komunikohen te palë të treta ose te publiku, në çfarëdo forme komunikimi dhe transmetimi, përherë duke përmendur kontributin e të dyja palëve. Ky parashikim do të vlejë përherë dhe i shtrin efektet e tij detyruese mbi palët edhe në rast se kjo marrëveshje zgjidhet, për ato iniciativa, aktivitete apo bashkëpunime që kanë filluar mes palëve gjatë kohës që marrëveshja ka qënë në fuqi.

Neni 6

Kufizimet/Garancia

1. Palët merren vesh, se asnjë ndërhyrje në veprimtaritë dhe funksionet e secilës prej tyre nuk do të nënkuptohet si rezultat i këtij bashkëpunimi.
2. Të dyja palët nënkuptojnë, se ato nuk mund të përdorin imazhe ose përshkrime të dëshmive, intervistave, filmave, punimeve, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen palës tjetër, ose këtij bashkëpunimi, në mënyrën që imponon miratimin ose sanksionimin nga ana e palës tjetër ose të aktiviteteve të tyre.

3. Palët merren vesh që vulat e secilës prej tyre, markat tregtare, logot, shenjat e shërbimit, emrat tregtarë, të cilët mund të jenë të pranishëm në faqen e internetit të secilës, nuk do të keqpërdoren nga asnjëra prej tyre, në mënyrë të tillë që të nënkuptohet se aktivitetet e secilës prej palëve janë miratuar, sponsorizuar ose rekomanduar nga pala tjetër, si dhe nuk do të përdoren si fakt për të qenë superiorë ndaj ndonjë produkti apo shërbimi tjetër.

4. Në kuptim të këtij neni, palët merren vesh dhe pranojnë të garantojnë njëra-tjetrën, se në kuadër të përdorimit të njëanshëm të materialeve që mund të vënë në dispozicion në shërbim të njëra-tjetrës, ato nuk do të mbajnë përgjegjësi për keqinterpretimin dhe keqpërdorimin që mund të bëhet nga pala tjetër që është marrëse dhe përdoruese e këtij materiali ose nga një palë e tretë.

Neni 7

Shpërndarja e materialeve

1. Materialet e mbledhura dhe të krijuara rishtas si rezultat i bashkëpunimit, mund të publikohen dhe të transmetohen anembanë në platforma të shumëfishta të transmetimit, nën siglën e të dyja palëve. Kjo mund të bëhet edhe në rast se marrëveshja zgjidhet, e në këtë rast palët detyrohen të zbatojnë parashikimet e pronësisë intelektuale sipas kësaj marrëveshjeje dhe ligjit në fuqi për pronësinë intelektuale.

2. Materialet, si dhe aplikimi përmes formularëve “online” të të dyja palëve, mund të referohen në mënyrë të ndërsjellë nga palët, në faqet e tyre zyrtare dhe zyrat përkatëse, kur diçka e tillë është e mundur dhe kërkohet prej palëve.

Neni 8

Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje dhe për mbarëvajtjen e saj, palët merren vesh për caktimin e personave të kontaktit, të cilët do të luajnë rol koordinues për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

2. Secili institucion do të caktojë një koordinator përgjegjës për të lehtësuar komunikimin dhe zbatimin e veprimtarive të përbashkëta, të cilët do të jenë përgjegjës për organizimin e takimeve, shkëmbimin e informacionit dhe ndjekjen e detyrave të përcaktuara në këtë marrëveshje. Ky koordinator më tej do t'i komunikohet dhe palës tjetër.

3. Koordinatorët do të mbajnë takime ndërmjet tyre (fizikisht dhe/apo virtualisht) në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacionit, si dhe do të informojnë titullarin përkatës të institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, për të vlerësuar programin e bashkëpunimit dhe të planeve të shkëmbyera e të përbashkëta në përputhje me parashikimet që përmban kjo marrëveshje, me synim caktimin e hapave të mëtejshëm.

4. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit elektronik.

5. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohen personat e parashikuar në pikat e mësipërme.

Neni 9

Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.

2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë, do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e të dyja palëve, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjë në fuqi vetëm pas nënshkrimit nga të dyja palët.

Neni 10

Mirëbesimi

1. Palët do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.

2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet, që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis palëve.

Neni 11

Forca madhore

1. Moskryerja apo kryerja me vonesë nga ana e një pale të ndonjë prej detyrimeve të saj sipas kësaj marrëveshjeje nuk do të konsiderohet shkelje e përcaktimeve të kësaj marrëveshjeje nëse një mos përmbushje apo vonesë e tillë vjen drejtpërsëdrejti për shkak të ndonjë ngjarjeje të “Forcës Madhore”.

2. Për qëllime të këtij neni, “Ngjarje e Forcës Madhore” ka kuptimin e ngjarjes ose situatës që shkon përtej kontrollit të secilës prej palëve, e cila nuk është e parashikueshme, është e pashmangshme dhe nuk shkaktohet nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit nga secila palë. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen aspak vetëm në, veprime të ndonjëres palë, të cilat nuk janë në kapacitetin e saj sovran ose kontraktual, siç mund të jenë luftërat ose revolucionet, zjarret, përmytjet, epidemitë/pandemitë, kufizimet e karantinës, fatkeqësitë natyrore, embargo e mallrave, etj.

3. Nëse ndodh një ngjarje e Forcës Madhore, pala e prekur nga ndikimi i saj ka detyrimin që të njoftojë sa më parë që të jetë e mundur palën tjetër me shkrim për gjendjen e tillë dhe shkakun e saj. Në qoftë se nuk udhëzohet ndryshe nga pala tjetër me shkrim, pala e prekur do të vazhdojë të kryejë dhe përmbushë detyrimet e saj sipas marrëveshjes për aq sa është e arsyeshme dhe e aplikueshme, si dhe do të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për realizimin që nuk pengohen apo ndikohen nga ngjarja e Forcës Madhore.

4. Me të përfunduar gjendja dhe ndikimet që mund të shtrihen edhe pas përfundimit të ngjarjes së Forcës Madhore, pala e cila ishte prekur nga ky ndikim do të vijojë me përmbushjen e detyrimeve që i takojnë sipas kësaj marrëveshjeje njëllor si përpara ndodhisë së ngjarjes së Forcës Madhore.

Neni 12

Afati i marrëveshjes

1. Marrëveshja do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, që nis që nga nënshkrimi i saj, me të drejtë rishikimi.

2. Marrëveshja mund të përfundohet dhe të zgjidhet nga secila palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, të paktën një muaj përpara.

3. Në rast të përfundimit të kësaj marrëveshjeje, palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj, dhe për pronësinë intelektuale të materialeve/produkteve të krijuara si rrjedhojë e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

Neni 13

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.

Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe dy të tjera do të depozitohen në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi".

PËR

**AUTORITETIN PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-
SIGURIMIT TË SHETIT**

KRYETARI

Gentiana Sula



PËR

**UNIVERSITETIN E SHKODRËS
"LUIGJ GURAKUQI"**

REKTORI

Prof.dr. Tonin Gjura

